



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr. 3, datë 24.02.2020

PËR

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME PËR
FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP, MIRATUAR ME VKD NR.7,
DATË 16.02.2017”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 24.02.2020, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkzionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme për Funkzionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin e KD-së nr.7, datë 16.02.2017”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 114 dhe 115 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji nr.9918/2008*);
2. Ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
3. Gërma c), pika 3, e nenit 20, të Rregullores së Brendshme për Funkzionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me VKD Nr.7, datë 16.02.2017.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, si më poshtë:

- a) Urdhri nr.31, datë 04.02.2020, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e disa ndryshimeve në aktin administrativ “Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP”;
- b) Relacioni shpjegues i projekt aktit;
- c) Projekt Akti i formatuar;

Si dhe referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

V Ë R E N:

1. Me Urdhrin nr.31, datë 04.02.2020, të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, është ngritur grupi i punës me qëllim kryerjen e procesit të ndërhyrjes normative për disa ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP. Nisma për ndryshimet në aktin normativ “Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me VKD Nr. 7, datë 06.02.2017, legjitimohet për shkak të domosdoshmërisë së autoritetit publik për të përmirësuar procedurat administrative të brendshme në funksion të ushtrimit të veprimtarisë institucionale në përputhje me regjimin e së drejtës administrative. Në këtë kontekst, bazuar dhe në nevojën për zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi dhe të rregullimeve ligjore në lidhje me procedurat e hartimit të akteve administrative, Këshilli Drejtues i AKEP vlerëson të domosdoshme ndërhyrjen normative në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP.
2. Akti administrativ i Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, ka caktuar si prioritet të këtij grupi pune, kryesisht përmirësimin e procedurave të përgatitjes së praktikës dokumentare, të parashikuar në Rregulloren e Brendshme për Funksionimin e KD-së të AKEP, ngushtësisht lidhur me mirëpërcaktimin e procedurës për dhënien e vlerësimit, mendimeve përveç aspektit formal edhe për përputhshmërinë ligjore, argumentimin dhe interpretimin ligjor për projekt aktet/projektvendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, nga Drejtoria Juridike dhe Integritit.
3. Konkretisht, neni 13 rregullon proceduralisht procesin administrativ të hartimit, verifikimit dhe më tej miratimit të projekt akteve të cilat paraqiten për vendimmarrje në mbledhjen e KD-së të AKEP. Qartësisht vërehet, se dispozita nuk parashikon në asnjë rast momentin e vlerësimit ligjor të projekt akteve nga struktura përgjegjëse në AKEP, përgjegjëse për realizimin e mbështetjes dhe kontrollit ligjor të veprimtarisë administrative dhe rregullatore që AKEP kryen si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe postare. Aktualisht, procesi i vlerësimit ligjor të projekt akteve që dërgohen/përcillen pranë Këshillit Drejtues për vendimmarrje rregullohet në aktet e tjera normative, *Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Administratës së AKEP*, por nuk gjendet e sanksionuar, e disiplinuar apo e standardizuar në nenin 13 të

Rregullores për Funkcionimin e KD-së. Sa më sipër, mbetet e qartë nevoja për ndërhyrje në dispozitë në fjalë, me qëllim saktësimin dhe disiplinimin e procedurave që do të duhet të ndiqet për çdo rast nga njësitë përgjegjëse/personat apo grupet e punës të ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit të praktikës dokumentare për shqyrtim pranë KD-së, si dhe për materializimin e vlerësimit/qëndrimit të strukturës përgjegjëse pranë AKEP për mbikëqyrjen e përputhshmërisë ligjore të akteve.

4. Sa më lart, Këshilli Drejtues mori në shqyrtim propozimin e grupit të punës të ngritur me Urdhrin nr.31, datë 04.02.2020, të Kryetarit të Këshillit Drejtues. Në vlerësim të Këshillit Drejtues të AKEP, shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, të propozuara nga grupi i punës i janë në përputhje me synimet dhe funksionet e AKEP, si dhe në harmoni të plotë me regjimin e të drejtës administrative. Me ndryshimin e bërë nëpërmjet këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP, gjykon se përmirëson Rregulloren “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike, miratuar me Vendimin nr.07, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 1.1, të nenit 19, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KD-së, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues”.
2. Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, i shtohet dhe “ANEKSI 1- Format Standard Relacion Shpjegues i Projekt Akteve të KD-së”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ndryshimet dhe shtesat e miratuara me këtë Vendim të reflektohen plotësisht në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e KD-së, miratuar me VKD Nr.7, datë 16.02.2017.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare online të AKEP, www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Ketrin Topçiu

Xhoana Lilaj